



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:012456

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429464

P.2021:012457

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK - Gjyqtari Burim Çaka në çështjen penale kundër të pandehurit: A.L i akuzuar për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.75/21 të datës 22.01.2021, sipas detyrës zyrtare, më datë 08.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Hedhet poshtë Aktakuza e Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.75/21 të datës 22.01.2021 ndaj të pandehurit A.L për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së

II. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën me numër P PP/II.nr.75/21 të datës 22.01.2021, ndaj të pandehurit A.L për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata më datë 23.01.2024 ka marrë aktvendim me të cilën ka kërkuar nga Prokuroria Themelore Ferizaj që në afat prej 30 ditësh të bëjë plotësimin e aktakuzës PP/II.nr.75/21 të

datës 22.01.2021 dhe ka kërkuar që: Të prezantohet si provë në këtë Gjykatë lidhur me faktin se të pandehurit të paktën i është dhënë mundësia që të deklarohet me shkrim sipas nenit 151 paragrafi 1 të KPP-së dhe e ka njoftuar lidhur me pasojat për mos plotësimin e sajë.

Prokuroria Themelore Ferizaj më datë 25.01.2024 ka pranuar Aktvendimin P.2021:012457 të datës 23.01.2024

Prokuroria Themelore Ferizaj brenda afatit të dhënë nga gjykata nuk ka kthyer përgjigjie dhe nuk ka kërkuar afat shtesë, me qrast Gjykata ka vlerësuar se Prokuroria Themelore Ferizaj nuk ka vepruar sipas Aktvendimit .2021:012457 të datës 23.01.2024 , aktakuzën nuk e ka plotësuar si në pikat e kërkuara.

Sipas vlerësimit të gjykatë, bazuar në dispozitën e nenit 151 paragrafi 2 të KPP-së (Kodi nr. 04/L-123 i procedurës penale), i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është ngritur aktakuza në paragrafin 2 parashihet: *Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Nëse i pandehuri hetohet për veprë apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se tre (3) vjet burgim, mjafton që të pandehurit t'i jepet mundësia që të përgjigjet me shkrim.* Gjykata ka vlerësuar se kjo dispozitë ligjore neni 151 paragrafi 2 të KPP-së (Kodi nr. 04/L-123 i procedurës penale) nuk është respektuar në rastin konkret, pasi që për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 vejt, ku të pandehurit është dashur që të paktën ti ipet mundësia të deklarohet me shkrim para ngritjes së aktakuzës.

Po ashtu sipas njohurive zyrtare të gjykatës, i pandehuri gjendet në arrati që nga viti 2018, për një numër të lartë të veprave penale të vjedhjes së pyllit, lidhur me këtë gjykata është në njohuri për faktin se ka të lëshuar urdhër arreste dhe letër rreshtim, i cili është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Andaj në bazë të nenit 241 dhe 441 paragrafi 4 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK,

P.nr.2021:012457 datë 08.03.2024

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.